

## Ndalim-afrimi

Ligji për ndalim-afrimin ka për qëllim të parandalojë krimet dhe përmirësojë mundësitë e ndërhyrjes në raste shqetësimesh të rënda. Ndalim-afrimi nënkupton që për ruajtjen e jetës, shëndetit, lirisë ose qetësisë së një personi, mund t'i ndalohej një personi tjetër që të marrë kontakt me atë. Ndalim-afrimi mund të jepet edhe në rastet kur personi që mbrohet dhe personi kundër të cilit jepet ndalesa, banojnë në të njëjtën banesë.

Përditësuar më 23.11.2012  
Ministria e Drejtësisë

## Kush mund ta kërkojë ndalim-afrimin?

Raste tipike ku mund të përdoret ndalim-afrimi janë shqetësimi i shkaktuar nga ish-bashkëshorti (bashkëshortja), apo nga ish-partneri (partnerja), me anë të përpjekjeve për të marrë kontakt e me bërjen e vizitave, si dhe rastet kur fëmija në moshë të rritur kërcënon prindin e moshuar për para. Me anë të ndalim-afrimin mund të mbrohet edhe dëshmitari në gjyq.

Rregullat mbi dhënien e ndalim-afrimin brenda familjes mund të zbatohen edhe kur personat banojnë bashkë ndonëse nuk janë si çift. Kjo ndalesë është e mundur edhe atëherë kur prindi pëson dhunë nga fëmija në moshë madhore që jeton bashkë me të.

Ndalim-afrimin mund ta kërkojë çdo person i cili e ndjen veten të kërcënuar ose të shqetësuar nga dikush tjetër.

Në rast se personi vetë nuk ka guxim ose nuk mundet ta kërkojë ndalim-afrimin, atëherë prokurori, autoritetet policore dhe sociale mund ta kërkojnë vendosjen e ndalim-afrimin.

## Si kërkohet ndalim-afrimi?

Në qoftë se je në situatë të rrezikshme e ndihesh i kërcënuar dhe mendon se ndalim-afrimi do të të ndihmojë, atëherë mund të kërkosh këshilla dhe ndihmë nga policia, autoritetet sociale, prokurori ose nga organizatat vullnetare.

Ndalim-afrimi kërkohet me shkrim ose me gojë nga policia ose direkt nga gjykata komunale. Kur kërkon ndalim-afrimin duhet të tregosh

- në çfarë lloj rreziku ke qenë apo je
- nga kush të vjen kërcënimi apo shqetësimi
- mendimi yt mbi vazhdimin e shqetësimit apo mbi rrezikun e këtij krimi
- a ka dëshmitarë apo prova për çështjen

Është me rëndësi që të mbash shënim e të mbledhësh të gjitha provat e informacionet e dëshmitarëve në mbështetje të kërkesës tënde për ndalim-afrim.

Në qoftë se ke qenë viktimë e një akti të dhunshëm, atëherë shko, së pari, të kontrollosh plagët (dëmtimet) tuaja te mjeku.

**Vendimin për ardhjen në fuqi të menjëhershme të ndalim-afritit të përkohshëm** mund ta japë vetëm nëpunësi që ka të drejtë të arrestojë, pra polici ose prokurori i rangut të lartë, ose gjykata komunale.

Zakonisht ndalim-afrimi që ka të bëjë me personat e së njëjtës familje vendoset nga policia dhe hyn në fuqi menjëherë si dhe është i natyrës së përkohshme. Kështu ndodh në ato raste kur policia largon nga shtëpia personin e sjellë kërcënueshëm dhe e mban atë në qeli si dhe kur rreziku i kërcënimit ekziston edhe pasi personi të dalë nga qelia.

## **Përmbajtja e ndalim-afritit**

Personi të cilit i është dhënë **ndalim-afrim i zakonshëm** nuk mund ta takojë personin e mbrojtur, as ta kontaktojë atë, madje as edhe të përpiqet për ta kontaktuar. Personi nën mbrojtje nuk duhet të ndiqet e as të mbahet nën vëzhgim.

**Ndalim-afrimi i zgjeruar** nënkupton edhe ndalimin e të qënurit në vende të caktuara, si në apartamentin e personit nën mbrojtje, në shtëpinë e tij të pushimit, në vendin e punës si dhe në afërsi të vendeve të përcaktuara veçanërisht nga gjyqi.

Personi ndaj të cilit është vendosur **ndalim-afrimi brenda familjes**, duhet të largohet nga banesa e përbashkët dhe të mos kthehet atje. Gjithashtu, ai (ajo) nuk mund të takojë as të kontaktojë me personin i cili mbrohet me anë të ndalim-afritit. Gjithashtu, është e ndaluar ndjekja ose mbajtja nën vëzhgim e personit nën mbrojtje. Edhe ndalim-afrimi brenda familjes mund të jepet **i zgjeruar** që të përmbajë qëndrimin në vende të caktuara, psh në afërsi të banesës së përbashkët.

Ndalim-afrimi vendoset vetëm në atë shkallë çka shihet si e nevojshme. Ndalim-afrimi nuk pengon takimet për punë që mund të ndodhin mes palëve. Takimet janë të lejuara, pavarësisht nga ndalimi-afrimi, në rast sëmundje të fëmijëve të përbashkët.

Rastet e parashikuara duhet të merren parasysh kur merret vendimi i ndalim-afritit. Për shembull, takimet me fëmijët ose takimet që kanë të bëjnë me ndarjen e pasurisë mund të caktohen të bëhen në praninë e punonjësit social ose në prezencën e një personi të tretë.

Ndalim-afrimi brenda familjes nuk duhet të pengojë detyrat financiare të palëve (psh: pagesën e qirasë), çështjet e pronësisë ose të qirasë, ose ndarjen e pasurisë së luajtshme. Përcaktimi i ndalesës nuk ka pasoja legale në kujdesjen e fëmijëve të përbashkët, në të drejtat e takimeve ose në pagesën e alimentacionit. Takimet me fëmijët duhet të organizohen veças.

## **Kohëzgjatja e ndalim-afritit**

Ndalim-afrimi është në fuqi për kohën që e cakton gjyqi, maksimumi për një vit, por në rast nevojë mund të vazhdohet. Për vazhdimin e ndalimafritit duhet të paraqitet kërkesa dhe të bëhet shqyrtimi i saj në gjyq.

Megjithatë, ndalim-afrimi brenda familjes mund të jepet maksimumi për tre muaj. Qëndrimi në fuqi i ndalesës shqyrtohet sipas çështjes në fjalë. Në rast nevojë ndalesa mund të shtyhet edhe për tre muaj të tjerë.

## Lënda e ndalim-afritit në gjykatën komunale

Kërkesa për ndalim-afritim shqyrtohet si çështje urgjente në gjykatën komunale. Çështja shqyrtohet si çështje penale në seancë gjyqësore, ku shqyrtohet lënda e paraqitur dhe dëgjohej të dyja palët pjesëmarrëse si dhe dëshmitë e dëshmitarëve të mundshëm.

Në dhënien e ndalesës gjyqi vlerëson rrezikun e shkeljes ligjore apo të shqetësimit sipas rastit në fjalë. Si bazë për këtë merren rrethanat, eksperiencia e personit si dhe dëshmitë e dëshmitarëve të mundshëm.

Si argumentë të rëndësishëm mund të konsiderohet dhuna e ushtruar, por edhe kjo nuk përcakton dhënien e ndalesës. Gjithashtu, edhe shqetësimi i personit që ndihet i kërcënuar në vendin ku banon, në vendin e punës apo në vende publike ose ngacmimi duke e mbajtur nën vëzhgim pa shkak, mund të jetë argument i mjaftueshëm për dhënien e ndalim-afritit. Edhe shqetësimi në vijim me anë të telefonatave, me anë të letrave ose me ndonjë mënyrë tjetër mund të shkaktojë dhënien e ndalim-afritit.

### Parakushtet e forta të ndalim-afritit brenda familjes

Meqë detyrimi për tu larguar nga shtëpia është ndërhyrje më e fuqishme në të drejtat e njeriut se ndalim-afritimi i zakonshëm, parakushtet e ndalim-afritit brenda familjes janë më të forta se ndalim-afritimi i zakonshëm. Ndalesa mund të jepet vetëm në rast shkelje që ka të bëjë me kërcënimin e jetës, të shëndetit ose të lirisë ose për të parandaluar kërcënimin e të lartpërmendurave, dhe jo në rast se kemi të bëjmë me prishje ose shqetësim të qetësisë. Për më tepër kërkohet evidentim më i qartë në mënyrë që mosdhënia e ndalim-afritit të ketë si pasoja shkeljet e lartpërmendura.

Vërtetimi i provave të kërcënimit mund të jetë, ndonjëherë, i vështirë. Në se pala tjetër nuk e pranon shqetësimin, atëherë për nxjerrjen e të vërtetës, do të ishte mirë që një person i jashtëm ta ketë vënë re shqetësimin. Kontaktet e mëparshme me policinë e me punëtorin social mbështetin provat. Dëshmitë nga mjeku, mesazhet e shkruara ose evidenca teknike si dhe deklaratat e dëshmitarëve, psh, e fqinjëve apo e shokëve të punës shërbejnë si sqarime mbi kërcënimin.

Ndihmë juridike në proceset gjyqësore japin ndihmësit publikë ligjorë, avokatët si dhe juristë të tjerë. Nga zyra për ndihmë juridike mund sqarosh a ke mundësi të marrësh ndihmës ligjor të paguar nga shteti.

Gjykata komunale vendos mbi çështjen e ndalim-afritit edhe kur personi të cilit i jepet ndalimi nuk paraqitet në gjyq. Ndalim-afritimi hyn në fuqi menjëherë pas marrjes së vendimit.

Në qoftë se ndalim-afritimi shihet më vonë si i panevojshëm, për anulimin e tij i bëhet lutje gjykatës komunale. **Palët pjesëmarrëse nuk mund të vendosin midis tyre mbi mbarimin e ndalim-afritit.**

## Thyerja e ndalim-afritit

Thyerja e ndalim-afritit është akt i dënueshëm. **Si dënim vihet një gjobë ose maksimumi një vit burg.** Thyerja e ndalim-afritit është krim që çon në akuze zyrtare, të cilën prokurori e shpie në gjyq.

Ndalim-afritimi shënohet në regjistrin e veçantë të policisë.

Policia mbikqyr dënimet e dhëna e mund të përdorë edhe masa të detyrueshme, në rast shkelje të ndalim-afritit. Në qoftë se, për shembull, personi të cilit i është dhënë ndalim-afrimi vazhdon të shqetësojë personin nën mbrojtje, polici i thirrur në vendine ngjarjes mund ta paraburgosë dhe të marrje masat e tjera për interrogimin e shkelësit të ndalim-afritit.

## Vepra kështu:

- në se ke qenë apo je duke u bërë viktimë e akteve të dhunshme apo shqetësimit, njofto policinë
- mund të kërkosh prej policisë vendosjen e përkohshme të ndalimafritit
- gjithashtu, mund të kërkosh ndihmë nga organet e zyrës sociale ose t'i drejtohesh për këshilla organizatave këshilluese
- sipas nevojës drejtohuni për ndihmë te personat ekspertë të çështjeve të tilla
- pas dhënies së ndalim-afritit, mendo ç'mund të bësh më shumë për rritjen e sigurisë tuaj, psh, në se duhet të ndërrosh bravat etj.
- Kontrolllo vetë aktivisht që ndalim-afrimi të mos shkelet
- lajmëro menjëherë policinë në se ndalim-afrimi është shkelur
- mos ki frikë të veprash në mbrojtjen tënde dhe të familjes

Numri i urgjencës i Policisë 112

## Këshilla dhe ndihma në çështjet e ndalim-afritit

Autoritetet zyrtare të mëposhtme këshillojnë dhe udhëzojnë në çështjet e ndalim-afritit:

- autoritetet policore

<http://www.poliisi.fi/poliisi/home.nsf/pages/0C8BF3843A3BDD28C2257530002EC9AC?opendocument>

- autoritetet sociale: kontaktoni me zyrën e komunës ku banoni.

Informacionet e kontaktit të komunave sipas rendit alfabetik të emrave të komunave:

<http://www.kunnat.net/fi/Yhteystiedot/kunta-alan-yhteystiedot/kunnat/Sivut/default.aspx>

**Organizat** e mëposhtme këshillojnë dhe udhëzojnë në çështjet e ndalim-afritit:

- Shtëpia më e afërt strehimore [www.turvakoti.net](http://www.turvakoti.net)

[https://www.turvakoti.net/site/?lan=1&page\\_id=8](https://www.turvakoti.net/site/?lan=1&page_id=8)

- Kujdestaria për viktimat e krimeve [www.rikosuhripaivystys.fi](http://www.rikosuhripaivystys.fi)  
Telefoni që ju ndihmon **0203 16 116**, e hënë - e martë 13-21, e mërkurë – e premte 17- 21  
Këshilla juridike tel. **0203 16 117** e hënë – e enjte 17-19

- Qendra për çështjet e përdhunimeve Tukinainen:

**[www.tukinainen.fi](http://www.tukinainen.fi)**

**[www.nettitukinainen.fi](http://www.nettitukinainen.fi)**

Urgjenca falas tel. **0800 97899** e hënë – e premte 9-15,  
e shtunë – e dielë, **gjatë festave dhe vigjiljeve të tyre** 15-21

Urgjenca juridike falas tel. **0800 97895** e hënë – e enjte 13-16

- Linja e grave **[www.naistenlinja.fi](http://www.naistenlinja.fi)**